



Pranuar / Dorezuar Priljehoj/Prodato Received/Delivery	22. 11. 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinita Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	7332	2022	1110



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.831/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.831/2022 të datës 28.09.2022 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë rruga _____ kundër organit të punësimit Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.11.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet ankesa me numër A.nr.831/2022 e datës 28.09.2022, e parashtruar nga ankuesi _____ si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ më datë 28.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 5715/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 20.09.2022 të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme (me tej DMZP) lidhur me pamundësinë e vazhdimit në procedurën e rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN010009664 të datës 04.08.2022 për pozitën e punës “Drejtor Ekzekutiv” në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe shkeljeve të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli më datë 12.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova:

Ankesën me numër të protokollit 5715/2022 të datës 28.09.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Konkursin e datës 04.08.2022 me numër reference RN00009664 për pozitën “ Drejtor Ekzekutiv” në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë”; Emalin e datës 20.09.2022 të A.Kamberaj drejtuar ankuesit; Emalin e datës 20.09.2022 të ankuesit drejtuar Emalin e datës 22.09.2022 të A.Kamberaj drejtuar ankuesit; Emalin e datës 21.09.2022 të drejtuar ankuesit; Emilin e datës 22.09.2022 të ankuesit drejtuar Emalin e datës 22.09.2022 të drejtuar ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5911/2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 6115/2022 të datës 1210/2022; Njoftimin e datës 20.09.2022; Vendimin nën shenjë VK.nr.143/2022 të datës 08.11.2022 për vazhdimin e afatit për vendim marrje edhe për dhjetë ditë pune të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Provat shtesë të protokolluara me numër 6756/2022 të datës 07.11.2022 lidhur me ofrimin e dëshmimeve shtesë; Njoftimin e datës 20.09.2022; Aplikacionin e datës 08.09.2022 të ankuesit; Diplomën universitare me numër 739 të datës 16.09.2019; Vërtetimin me shenjë LRP.Nr.789 lidhur me motorizimin e diplomës universitare; Diplomën Universitare me numër 273 të datës 23.06.2019; Vërtetimin më shenjë LRP.Nr.789 lidhur me motorizimin e diplomës universitare; Diplomën me numër 121 të datës 21.07.2020 lidhur me gradën e fituar “ Doktor” i shkencave dhe prodhimit shtazor; Vërtetimin më shenjë Lrp.nr. 2071/2022 të datës 26.05.2022 lidhur me motorizimin e diplomës të datës 21.07.2020; Vendimin me numër Ref:1/6-2704 të datës 11.05.2021; Certifikatën me numër 292 të datës 05.10.2004 lidhur me përfundimin e shkollës së kompjuterëve; Certifikatën me numër 292/2 të datës 15.11.2004; lidhur me përfundimin e shkollës së kompjuterëve; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit “Introducion to SPSS” (pa datë dhe numër); Vërtetimin me Nr.08-01 të datës 01.11.2007; Vendimin me numër 02/226-112 të 22.06.2010; Vendimin me numër 02-112-8939 të datës 05.02.2014; Certifikatën e datës 29.08.2022 nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke zhvilluar procedura penale dhe persnave të dënuar nga kjo gjykatë; Letër motivimi pa datë; Vendimin me Nr.026/2015 të datës 04.03.2015; Vendimin me numër 02-101/03-0010583/18 te datës 14.02.2018; Kontratën me numër të protokollit 1190/43-01 të datës 09.10.2021 për themelimin e marrëdhënies se punës me normë të plotë; Dokumentin e identifikimit; Dosjen e kandidatit Aplikacionin e datës 09.09.2022; Diplomën universitare me numër 163/1108 te datës 07.11.2008; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit “Kontabilitet ALPha” të datës 13.12.2006; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit e datës 25.09.2009; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit “partneriteti publik” për periudhën kohore 25-28.02.2010; Certifikatën 2011-2013; Certifikatën e avancuar profesionale për prokurim për periudhën kohore 2014-2016; Kontratën e punës të datës 30.03.2004; Marrëveshjen me numër 012 të datës 02.07.2007; Kontratën e punës të datës 01.12.2007; Kontratën e punës me numër 902 të datës për periudhën kohore 01.07.2009 deri 30.06.2010; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “Zyrtar Prokurimit”; rregullat e mirësjelljes se shërbimit civil; Kontratën e marrëdhënies se punës me numër 1092/2010 për periudhën kohore 01.07.2010 deri me datës 30.06.2013; Shtojcën lidhur me rregullat e mirësjelljes se shërbimit civil; Akt emërimit të datës 31.01.2012; Certifikatën me numër 078 për themelimin profesional për prokurim për periudhën kohore 2017-2019; Certifikatën e avancuar profesionale për prokurim e lëshuar në vitin 2020; Certifikatën e notave viti 2011; Diplomën universitare me numër 312-02/9-19 të datës 15.08.2019; Dokumentin e identifikimit; Letrën motivuese pa numër; Ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimit të datës 20.01.2017; Kontratën e marrëdhënies së punës për periudhën kohore 01.07.2009 deri me datën

30.06.2010; Kontratën e punës të datës 01.12.2007; Kontratën e punës të datës 30.03.2004; Kontratën e punës të datës 01.03.2004; Vendimin me numër të protokollit 1250 të datës 17.08.2016; Vendimin me numër 635 për emërimin e ushtruesit të detyrës së drejtorit të zyrës të prokurimit të datës 03.10.2011; Vendimin me numër 02 Ref:272 të datës 27.08.2013 për emërimin e ushtruesit të detyrës së udhëheqësit të divizionit të prokurimit; Vendimin me numër të protokollit 155 të datës 30.01.2015 për emërimin të ushtruesit të detyrës së udhëheqësit të divizionit të prokurimit; Certifikatën e datës 25.09.2009; Marrëveshjen për shërbime të veçanta për periudhën kohore 01.12.2011 deri me 31.12.2011; Marrëveshjen për shërbime të veçanta për periudhën kohore 01.11.2011 deri me datën 30.11.2011; Marrëveshjen për shërbime të veçanta për periudhën kohore 01.09.2011 deri me datën 31.09.2011; Aktin e emërimit të datës 31.01.2012; Kontratën e marrëdhënies së punës e datës 01.07.2009; Komenti në performancën e përgjithshme e datës 19.12.2011; Formulari i vlerësimit të kryerjes së punëve e datës 26.12.2012; Komenti në performancën e përgjithshme e datës e 26.12.2012; Formulari i vlerësimit të kryerjes së punëve e datës 02.05.2012; Marrëveshjen për shërbime të veçanta që i nënshtrohen ligjit të detyrimit e datës 02.03.2012; Marrëveshjen për shërbime të veçanta që i nënshtrohen ligjit të detyrimit e datës 01.02.2012; Marrëveshjen për shërbime të veçanta që i nënshtrohen ligjit të detyrimit të datës 06.01.2012; Marrëveshja për shërbime të veçanta qe i nënshtrohen ligjit të detyrimit e datës 01.12.2011; Shkresën e datës 19.12.2011; Letër Rekomandimi e datës 15.11.2021; Ndryshim dhe plotësim i aktit të emërimit i datës 20.01.2017; Përshkrimin e detyrave te punës i datës 20.01.2017; Referenca e datës 17.04.2019; Vërtetimi i marrëdhënies së punës i datës 08.09.2022; Vërtetimi i datës 08.09.2022; Dosjen e kandidatit Aplikacionin e datës 08.09.2022; Diplomën universitare me numër 036/19 e datës 19.07.2019; Diplomën universitare me numër 610 e datës 23.08.2012; Certifikatën e datës 20.09.2012 lidhur me përfundimin e trajnimit "Vetëdijesimin për zjarrin dhe trajnimin i zjarrfikës me aparate zjarrfikës"; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit " Business Communications, Sales the Negotiation Skills" e datës 25.06.2009; Certifikatën e datës 10.03.2003 lidhur përfundimin e trajnimit " Rural Cedrit Course"; Certifikatën e datës 10.01.2003 lidhur përfundimin e trajnimit " Cedrit Management Coures"; Certifikatën e datës 19.12.2002 lidhur përfundimin e trajnimit " Basic Banking Course"; Certifikatën e datës 18-19.10.2002 lidhur përfundimin e trajnimit " Psychosocial ëork and Crisis Menagement" e datës; Certifikatën e datës 06.01.2003 lidhur përfundimin e trajnimit kursit të gjuhës angleze; Certifikatën e datës 15.02.2017 lidhur përfundimin e trajnimit "Credit certification program"; Certifikatën e datës 08.12.2015 lidhur përfundimin e trajnimit " Excellence in sales"; Certifikatën e datës 01.10.2012 lidhur përfundimin e trajnimit "Credit registry softëare"; Letër referencën e datës 27.04.200; Certifikatën e datës 18.05.210 ; Certifikatën e datës 11.06.2010; Kontratën e punës e datës 01.07.2011; Certifikatën e datës 10.03.2000 lidhur me perëndimin e trajnimit "Bazat e informatikës"; Konfirmimi për masat disiplinore dhe vërejtjet për largim nga puna (pa datë); Letrën Motivuese (pa datë); Certifikatën e datës 19.08.2022 e leshura nga Gjykata; Pasqyrën e llogarisë (Trustit) e datës 07.09.2022; Dosja e kandidatit Aplikacionin datës 04.09.2022 ; Letër motivimin e datës 05.09.202; (CV) ; Diplomën universitare me numër 409 të datës 06.10.1987; Vërtetimin me numër reference 11.1-465/22 të datës 02.09.2022; Dokumentin e identifikimit; Certifikatën e datës 29.08.2022 të lëshuar nga Gjykata; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar " Quality management and marketing for agricultural commodities " nga data 15.02.2022 deri 05.03.2010; Certifikatën me numër 2018-04-1-1-1-007 të datës 11.12.2018 lidhur me trajnimin e përfunduar " Këshilltare për Bujqësi edhe Zhvillim Rural"; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar " Scottish agriculture -Policy and praticice" nga 29.06.2009 deri me 10.07.2009; Certifikatën e datës 4-6.05.2005 lidhur me trajnimin e përfunduar " Media and communication" ;

Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit për analizën e Çështjes Gjinore të mbajtur në periudhën kohore 26-29. 05.013; Certifikatën lidhur me përfundimin e kursit Posthavest technology short course; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit Masterplan i Bujqësisë financiar nga veshi për projektin e Kosovës ; Certifikatën e datës 05.12.2008 lidhur me përfundimin e trajnimit sipas programit Menaxhimi i Ciklik i projektit; Dosjen e kandidatit Aplikacionin e datës 09.09.2022; Diplomën me numër MD 000797 të datës 10.01.2010; Diplomën me Nr.678 të datës 09.02.1989; Vërtetimin e datës 18.04.2005 lidhur me marrëdhënien e punës në NSHB "Produkt"; Vërtetimin me numër 1820 të datës 14.04.2014 lidhur me vërtetimin e marrëdhënies së punës; Vërtetimin me numër 03/Nr.113-114 të datës 31.03.2005 lidhur me marrëdhënien e punës; Dokumentin e identifikimit; Letër motivimin e datës 08.07.2022 Formularin e vlerësimit të rezultateve të punës të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional të datës 29.01.2021; Formularin e vlerësimit të rezultateve të punës të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional të datës 31.01.2022; CV; Vërtetimin me numër Ref; 11-362/2020 të datës 13.08.2020; Vërtetimin me numër 63/2022 të datës 12.07.2022; Vërtetimin me numër 03/Nr.113-114 të datës 31.03.2005; Vërtetimin me numër 215 të datës 18.04.2005 lidhur me përvojën e punës në SHB "Produkt"; Vërtetimin me numër Ref;64/2022 të datës 12.07.2022 lidhur me dëshminë se i njëjti nuk ka masë disiplinore; Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë; Certifikatën e datës 09.09.2016 lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit Frekuentimi në ESA 14; Certifikatën e datës 21.07.2019; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Kontrolli i tregut" për periudhën kohore 28.02.-03.03.2017; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit IKAP-it të datës 20.12.2017 lidhur me temën dizajni dhe menaxhimi i politikave publike të Integritimit Evropian; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit të IKAP-it lidhur me temën "Modelin e konstitimit standard"; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin " Përafrimi i legjislacionit Vendor me legjislacionit e Bashkimit Evropian"; Certifikatën e datës 09.02.2005; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në kursin trajnues për çështje evropiane të mbajtur në Prishtinë; Certifikatën e datës 26.01.2018 lidhur me përfundimin e trajnimit më të mirë për ushqim me të sigurt; Certifikatën e datës 07.09.2012 lidhur me konferencën e Morvanit për kërkimin rural; Certifikatën e datës 05.07.2022 lidhur me vijimin e trajnimit për Analizën e Çështjes Gjinore; Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personat të dënuar; dokumentin e identifikimit; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Participantes Training Program" për periudhën 26.08.2005 deri me 04.09.2005; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Trande Polic Study Tour" për periudhën 26.08.2005 deri me 05.09.2005; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Project Cycles Management and Logical Framework" për periudhën 25-29.04.2005; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar për periudhën 4-6.05.2005; Certifikatën e datës 24.04.2006 lidhur me trajnimin e përfunduar " To Whom it May Concern"; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar " Trade Policy and the functioning of the World Trade Organization" për periudhën 04.09.2007-08.11.2007; Certifikatën e datës 25.10.2006 lidhur me trajnimin e përfunduar " Basic Economics and Policy Impact Analysis" ; Certifikatën e datës 2007 lidhur me trajnimin e përfunduar " 2007 Academy of to law and polic" ; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar " Trainig on the instrument for Accession (IPA) and Project cycle management (PCM) për periudhën Qershor - Shtator 2011; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar " Trening on the Instrument for pre-accession (IPA) e datës Prill 2011; Certifikatën e datës 28.10.2011 lidhur me trajnimin e përfunduar "Project management for regional and rural economic development (RREDI) ; Certifikatën lidhur me

trajnimin e përfunduar "Certificate of attendance" për periudhën 13-14.04.2015; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Core Marketing trening" (pa datë); Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Better training for safer food" për periudhën 09-12.11.2015; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Training on quality schemes" për periudhën 6-9.11.2012; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Economic Developmment" për përudhen 2-6.07.2012; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Trajner i Ikap" për periudhën dhjetor 2018-qershor 2019; Certifikatën e datës 07.10.2015 lidhur me trajnimin e përfunduar "Përafrimi i legjislacionit vendor me legjislacionin evropian" Certifikatën e datës 09.02.2005 lidhur me trajnimin e përfunduar "Participants training program" Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Institucional architecture, decision- making and daily functioning" per periudhën 6-8 .06.2011; Certifikatën lidhur me trajnimin e perënduar "Better training for safer food" për periudhën 23-26.01.2018; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Moravian conference on rural research" për përudhen 3-7.09.2012; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar " Analizën e çështje gjinore "për përudhen 26-29.03.2003; Certifikatën pa datë; Vendimi me ref.Nr.3782 te datës 04.11.2019; Diplomën e datës 10.06.2010; Certifikatën me numër ref.1/33 të datës 10.06.2010; Diplome me numër 678 të datës 09.02.1989; Certifikatën e datës 24.10.2003 lidhur me trajnimin e perënduar "Regulatory & Quality inferastructure development for food safety & Quality"; Certifikatën lidhur me trajnimin përfunduar "Science and techology felloës program" pa date; Certifikatën e muajit nëntor 2005 ; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Eurorural '12" për periudhën 03-07.09.2012; Certifikatën e datës 09.09.2016; Certifikaten e datës 02.08.2019; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Better training for safer food" për përudhen 28.02. deri me 03.03.2017; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Trajner i IKAP" për periudhën tetor 2016 - prill 2017; Dosjen e kandidatit Aplikacioni i datës 07.09.2022; Diplomën me numër protokolli:321/655 të datës 07.06.2003; Dilemën me numër 1686 të datës 16.07.2018; Diplomën me numër 46/16 të datës 24.10.2016; Certifikatën e datës 19-20.05.2022 lidhuri me trajnimin e përfunduar "Zhvillimi i kapitalit njerëzore" ; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Menaxhimi i kohës dhe delegimi i përgjegjësive" për periudhën 16-17.03.2022; Certifikatën lidhur me trajnimin " Zbatimi i ligjit për zyrtarët publikë (LZB) dhe rregulloret e saje" për periudhën 6-28.05.2021; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar " Human resources managemment " ne periudhën 29-30.10 ; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar " Ligji për procedurën e përgjithshme administrative" në periudhën 20-21.09.2018; Certifikatën lidhur me trajnimin "Planifikimi, Menxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore" në periudhën 7-8.11.2019; Certifikatën lidhur me trajnimin " State and Society" në periudhën shkurt-nëntor 2014; Certifikatën e vitit 2014; Certifikatën e datës 23.10.2008, lidhur me trajnimin e përfunduar " Udhëheqja ,Rritja e Fndeve dhe Komunikimi me Media; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar " Menaxhimi i kualitetit në shërbimin publik" në periudhën 18-21.09.2018; Vërtetimin e datës 11.10.2021; Vërtetimin e marrëdhënies së punës me numër protokolli: 976 të datës 03.07.2020; Vërtetimi i marrëdhënies se punës me numër 112/010/2022 të datës 17.01.2022; Referencën e datës 25.02.2008; Vërtetimin me Nr.01 të datës 09.07.2013; Referencën e datës 14.09.2011; Letër referencën e datës 25.12.2017; Letërnjoftimi; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil të datës 18.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 29.12.2020; Vërtetimin për masën disiplinore me numër 112/124/2022 të datës 30.05.2022; Biografia e kandidatit (CV); Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve nuk është duke u zhvilluar procedura penale dhe personat te dënuar të datës 17.05.2022; Dosja e kandidatës Aplikacioni i datës 08.09.2022; Diplomën e datës 11.04.2014; Diplomën e datës 20.10.2006; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar " Administrimi

i zyrës dhe sistemit i fjalimit" në periudhën 04-05.07.2002; Certifikatën (pa datë dhe numër); Certifikatën e vitit 2002 për periudhën 24-28.06.2002; Certifikatën pa numër pa datë; Certifikatën e vitit 2002; Certifikatën 18.07.2007 lidhur me trajnimin " Menaxhimi i projekteve" ; Kontratë e marrëdhënies së punës me numër 779/08 të datës 24.11.2008; Konkursi pa numër pa datë; Rregullat e mirësjelljes së shërbimit civil (pa datë); Kontratën e punës me numër 965/09 të datës 23.11.2009; Kontratën e marrëdhënies së punës me numër 1076/2010 të datës 05.05.2010; Konkursi për pozitën zyrtar për procedura administrative (pa datë dhe numër); Akte Emërimit të datës 30.01.2012; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar për Procedura Administrative pa date; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit të datës 19.11.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i sektorit për punës Juridike dhe Administrative të datës 12.11.2014; Certifikatën lidhur me trajnimin e përfunduar "Aftësimin Kompjuterik", me numër 12208-160 të datës 11.04.2005; Letërnjoftimi; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 27.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 31.12.2019; Vërtetimin të datës 28.10.2021; Vërtetimin të datës 28.10.2021; Letër Motivuese të datës 26.10.2021; Vërtetimin të datës 07.09.2022; Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve nuk është duke u zhvilluar procedura penale dhe personat të dënuar të datës 06.09.2022; Dosjen e kandidatit Aplikacionin e datës 11.09.2022; Diplomën me numër 34 të datës 17.09.2010; Diplomën me numër 506 të datës 06.10.1987; Vërtetim me numër 168/02 të datës 26.06.2002; Vërtetim me numër 132/2002 të datës 26.06.2002; Vërtetimin Ref: 04-2/216/09 të datës 03.08.2009; Vërtetimin e punës të datës 23.03.2018; Vërtetimin e datës 26.07.2019; Akt Emërimit me numër protokolli 2208/2 të datës 12.06.2019; dokumentin e identifikimit; Letër Motivimin e datës 10.09.2022; Biografia e kandidatit (CV); Vërtetimin me Ref:SBNJD-73/2022 të datës 13.07.2022; Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve nuk është duke u zhvilluar procedura penale dhe personat të dënuar të datës 12.07.2022; Certifikatën e muajit Maj 2002; Certifikatën e datës 6-24.09.2003; Certifikatën për periudhën të datës 19-23.11.2012; Certifikatën të datës 21.05.2010; Certifikatën për periudhën të datës 26-30.05.2003; Dosjen e kandidatit Aplikacion e datës 09.09.2022; Diplomën me numër 632 të datës 24.06.2009 të studimeve të themeluara pasuniversitare; Vendimin me Nr.614/993 të datës 22.10.2020; Diplomën me numër 104 të datës 22.04.2013; Vendimin me numër 614/992 të datës 22.10.2020; Diplomën me numër 638 të datës 05.04.2013; Certifikatën e datës 11.12.2018 për Këshilltar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural; Certifikatën për vijimin me suksese të seminarit i organizuar ne Kaçanik nga Swisscontact për periudhën kohore 7.08. deri me datën 06.09.2001; Certifikatën lidhur me trajnimin "Workshop in Kamenica 04.02.2022 Shkresën e datës 26.07.2010; Vërtetimin me numër Ref:SBNJD-95/2022 të datës 07.09.2022; Kontratën e punës me numër Ref NOA-G-038/15.12.2012/1 të datës 15.12.2011; Kontratën e punës me numër M041_01/2012; CV: shkresën e datës 07.02.2014; Formën e Kontratës për shërbime konsullore; Shkresën e datës 06.08.2018; Kontratën shtesë me numër 177/20 të datës 03.07.2020; Kontratën shtesë me numër 295/2020 të datës 05.10.2020; Marrëveshjen për shërbime të veçanta të datës 04.10.2021; Marrëveshjen për shërbime të veçanta nga data 07.03.2022 deri më datën 31.12.2022; Vendimin me NR.03/73 të datës 30.04.2022; Dokumentin e identifikimit; Deklaratën e datës 07.09.2022; Letër Motivimin; Certifikatën e datës 05.09.2022 nga evidenca e personave kundër të cilëve nuk është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë; Dosjen e kandidatit aplikacionin e datës 11.09.2022; Diplomën me numër 2593 të datës 16.05.2014; Vërtetimin më shenjë LRP.nr.3201/2014 lidhur me nostrifikimin e diplomës; Diplomën me numër 560 të datës 16.12.2013; Certifikatën (pa datë dhe numër) lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin Hartimi i raporteve dhe shkresave të zyrtarëve; Certifikatën (pa datë dhe numër) lidhur me përfundimin e trajnimit

“Satisfacition training sess je uspesno zarsio obukuna”; Certifikatën me numër 2013.09.18-28-74; Certifikatën e datës 22.07.2011; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen ne trajnimin Negociatat për nënshkrimin MAS dhe obligimet nga marrëveshja për periudhën kohore 14-15.05.2013; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit Local Governance Academy; Kontratën e marrëdhënies se punës me numër 115/1 të datës 27.01.2009; Kontratën e marrëdhënies se punës me numër 115/2 të datës 12.01.2010; Kontratën e marrëdhënies së punës 115/3 të datës 14.02.2011; Aktin e emërimit me numër Ref. ZS 0/01 të datës 01.12.2011; Ndryshim dhe Plotësimin e Akt emërimit të datës 19.02.2013; Ndryshim dhe Plotësimin e Aktit të emërimit të datës 08.01.2015; Ndryshim dhe plotësimin e akt emërimit të datës 21.12.2017; Vendimin me numër 112-526 të datës 10.05.2019; Vendimin me Nr. REf. AZHB07/4/118/2021 të datës 04.08.2021; Përgjigje në kërkesë të datës 30.12.2021; Vendimin me numër ref:KM-650/2021 të datës 11.08.2021; Vendimin me numër 02-22/10 të datës 12.04.2022; Certifikatën me numër Mc 1953561 të datës 16.01.2006; Certifikatën lidhur me përfundimin e kursit të anglishtes të datës 21.12.2009; Letër referencën e muajit Korrik-2022; Letër Rekomandimin e muajit Korrik-2022; Dokumentin e identifikimit; Formularin e rezultateve të vlerësimit në punë për periudhën 01.01.2021 deri me 04.08.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë nga 11.08 deri me 21.12.2021; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e vlerësimit 21.11.2020 deri me datën 31.12.2020; Vërtetimin e datës 07.07.2022; Letër motivimin e datës 08.06.2022; Shkresën e datës 27.06.2022; Certifikatën e datës 06.07.2022 nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat e marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur së Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 04.08.2022 ka shpallur Konkursin për praninë të hapur, me numër reference RN00009664 për pozitën e punës “Drejtor Ekzekutiv” në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, klasa drejtues i Lartë 2, me mandat katër (4) vjeçar, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi me datë 08.09.2022.

Me tej nga shkresat e lëndës rrjedh së Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me datë 20.09.2022 (përmes emalit) ka njoftuar ankuesin së nuk mund të vazhdoni në procedurë të mëtejme të rekrutimi për pozitën Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, me arsyetimin së i njëjti nuk ka ofruar dëshmi që nuk ka masë disiplinore për largim nga pozita e zyrtarit publikë ashtu siç është kërkuar në konkurs duke udhëzuar të njëjtin për sqarime në Njësinë Përgjegjëse, rrjedhimisht ankuesi nuk është përfshirë në listën e ngushtë të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret për aplikim në këtë pozitë.

Kundër njoftimit të datës 20.09.2022 të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë brenda afatit ligjor, ankuesi parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimi Civil të Kosovës, me pretendimin së Njësia përgjegjëse në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me rastin refuzimit të aplikacionit të ankuesit ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike si dhe shkelje të dispozitave materiale, pasi që ankuesi asnjëherë me konkurs publik nuk është përzgjedhur si zyrtar publik por që i njëjti ka ushtruar funksione të të emëruarit politik dhe së njoftimi i ankimuar nuk përmban elementet e aktit

administrativ siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Propozon që Këshilli ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën dhe të anuloj Konkursin me të gjitha pasojat juridike që derivojnë prej tij.

Në kuptim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i'u referua dispozitave ligjore lidhur me emërimin e pozitve të larta drejtuese, përkatësisht:

Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, neni 40 ka përcaktuar se: 1. *Pranimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese bëhet me konkurrim të organizuar për çdo pozitë të lirë. Fillimisht, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurrim vetëm nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil.* 2. *Konkurrimi organizohet nga ministria përgjegjëse për administratën publike për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për çdo institucioni tjetër shtetëror (në vijim Njësia e Pranimi).* 3. *Hapja e procedurës së konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 30 ditë, përpara datës të caktuar për paraqitjen e aplikimit, nga Njësia e Pranimi, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme.* 4. *Shpallja e konkurrimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, përfshin pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi, përshkrimi i punës, kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme, që duhet t'i plotësojnë kandidatët, të dhënat e hollësishtme për zhvillimin e konkurrimit, dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim dhe afatin për paraqitjen e aplikimit...* 9. *Në rast se procedura e konkurrimit përfundon pa të paktën dy kandidatë fitues të vlerësuar me më shumë se 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, organizohet një procedurë e dytë konkurrimi. Procedura e dytë e konkurrimit është e hapur dhe në të mund të marrë pjesë çdo kandidat, që i plotëson kërkesat e përgjithshme për pranimin në kategorinë e lartë drejtuese dhe kërkesat e posaçme për pozitën përkatëse nga brenda apo jashtë Shërbimit Civil..."*

Rregullores (QRK) Nr. 1/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të lartë drejtues e ligjor, neni 6 ka përcaktuar se: "1. *Procedura e konkurrimit për pozitën e kategorisë së lartë drejtuese organizohet nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë për institucionet e administratës shtetërore dhe nga njësia e burimeve njerëzore e institucionit, për institucionin tjetër shtetëror (në tekstin në vijim për të dy njësitë - Njësia përgjegjëse)....* 4. *Njësia e pranimi, bën njoftimin për hapjen e procedurës së konkurrimit për çdo pozitë të kategorisë së lartë drejtuese në afat jo më të shkurtër se tridhjetë (30) ditë kalendrike para datës të caktuar për pranimin e aplikacioneve.* 5. *Afati për pranimin e aplikacioneve është tetë (8) ditë kalendrike.* 6. *Njoftimi për shpalljen e konkursit për herë të parë është për nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil dhe bëhet në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit për nëpunësit civilë (SIMBNJ) dhe në ueb faqen e dhënat si në vijim:* 6.1. *titullin e pozitës për të cilën zhvillohet konkurrimi;* 6.2. *përshkrimin e përgjithshëm të punës për pozitën për të cilën zhvillohet konkurrimi;* 6.3. *kërkesat e përgjithshme për pranim sipas nenit 8 të Ligjit për Zyrtarët Publikë;* 6.4. *kërkesat e përgjithshme formale;* 6.5. *njohuritë, aftësitë dhe cilësitë që vlerësohen në procedurën e konkurrimit (kërkesat e përgjithshme të nevojshme);* 6.6. *kërkesat specifike që duhet t'i plotësojnë kandidatët sipas paragrafit 2 të nenit 5 të kësaj rregullore;* 6.7. *dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim, mënyrën, procedurën dhe afatin për paraqitjen e aplikimit.* 6.8. *datën e fillimit të zhvillimit të procedurës së konkurrimit;* 6.9. *datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak;* 6.10. *mënyrën e vlerësimit të kandidatëve;* 6.11. *datën për shpalljen e rezultateve për vlerësimin përfundimtar;* 6.12. *mënyrën e njoftimit/komunikimit me kandidatët, përmes postës elektronike;* 6.13. *mënyrën e aplikimit (përmes ueb aplikacionit - online);* 6.14. *informatën se për herën e parë kanë të drejtë të konkurojnë vetëm nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil; dhe* 6.15. *kërkesën për letër motivimin..."* Neni 7 ka përcaktuar se: ...3. *Së bashku me aplikacionin për konkurrim, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin plotësues në vijim:* 3.1. *kopjet*

e diplomave mbi kualifikimin arsimor, kurse për diplomat e marra jashtë vendit, nevojitet nostrifikimi; 3.2. kopjet e dëshmisë së punësimit që përfshin pozitën dhe datat e mbajtjes së pozitës; 3.3. kopjet e dokumenteve që dëshmojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion...9. Shpallja e hapur e konkurimit dhe pranimit i aplikacioneve bëhet në pajtim me paragrafin 4 dhe 5 të nenit 6 të kësaj Rregullore... Neni 8 ka përcaktuar se: Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikacionit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë konkurrimin në fazën e vlerësimit profesional... 5. Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet për aplikim nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Njoftimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim arsyetohet duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e papërmblushura dhe u dërgohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve. 6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin - kërkesë me shkrim për sqarime shitesë ose të paraqiten tek Njësia Përgjegjëse për t'u njohur me arsyet e detajuara për mos kualifikim për konkurim të mëtejshëm. 7. Njësia Përgjegjëse, brenda afatit prej pesë (5) ditëve kalendarike duhet të përgjigjet me shkrim në kërkesën e kandidatit si në paragrafin 6 të këtij neni, duke dhënë arsyet e detajuara për mos kualifikim për konkurim të mëtejshëm. 8. Kandidati i pa kënaqur me përgjigjen me shkrim si në paragrafin 7 të këtij neni, ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda afatit prej tetë (8) dite kalendarike pas pranimit të përgjigjes.

Sipas Konkursit me numër referencë RN00009664 për pozitën "Drejtor Ekzekutiv" në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, si kërkesat të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to në drejtimit: fakulteti i Farmacisë, Ekonomikut, Juridikut, Kimisë, Mjekësisë, Biologjisë, Fizikes. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese. Ndërsa si dëshmi janë kërkuar: *Kopjen e diplomës, mbi kualifikimin arsimor nostrifikimi për diplomën e marre jashtë vendit, Dëshmi për përvojën e punës ;Letër motivim ; Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës; Dëshmimi nëse nuk ka masë disiplinore për largimin nga pozita e zyrtarit publik në pesë vitet e fundit, kandidatet e jashtëm paraqesin deklaratë me shkrim të vetë nënshkruar për të dëshmuar se ndaj tyre nuk ka pasur masë disiplinore për largim nga pozita e zyrtarit publik në pesë vitet e fundit; Certifikatën nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendimin e formës së prere nga kryerja e ndonjë veprë penal me dashje .Si dhe çdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuar në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Andaj, bazuar në dispozitat ligjore si me sipër si dhe mbështetur në shkresat e lëndës Kolegji vlerësoj së Njësia Përgjegjëse përkatësisht Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ka vërtetuar drejt gjendjen faktike, ngase, ankuesi sipas vet pohimeve në ankesë si dhe bazuar në shkresat e lëndës i njëjti në pesë vitet e fundit nuk ka ushtruar ndonjë pozitë të zyrtarit publik dhe së me rastin e aplikimit nuk ka ofruar deklaratë me shkrim së ka pasur ndonjë masë disiplinore të shqiptuar gjata ushtrimit të funksioneve jashtë shërbimit civil/ zyrtarit publik, kërkesë kjo e përcaktuar në konkursin e shpallur, e mbi këtë bazë Kolegji konstaton së Njësia Përgjegjëse ka vepruar në pajtim me nenin 8 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues ku është përcaktuar se: *Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet për aplikim nuk kanë*

të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Njoftimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim arsyetohet duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e papërbushura dhe u dërgohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve..”

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit vlerëson së njoftimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë me shkelje procedurale siç pretendon ankuesi, sepse bazuar në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, nuk përcaktohet që në rastet ku kandidati nuk ka plotësuar kriteret / dëshmitë e konkursit të lëshohet akt administrativ por me nenin 8 paragrafi 5 dhe 6 të kësaj rregullore parashihet që kandidati të njoftohen individualisht lidhur me mosplotësimin e kriterëve dhe pamundësinë e vazhimit të mëtejme në procedurën e konkurrimit. Nderlidhur me këtë, e në kuptim të njoftimit të palës Kolegji ju referua nenit 108 të Ligjit Nr.056/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin theksohet se: 1. Të njoftuarit është komunikimi i qëllimtë nga një organ publik i një akti administrativ apo procedural, palës apo një personi tjetër i përfshirë në procedurën administrative (në vijim: “pala”). 2. Nëse nuk parashihet shprehimisht ndryshe me ligj, organi publik është i lirë të përcaktojë formën më të përshtatshme të të njoftuarit të një akti administrativ apo të çdo njoftimi tjetër në kuadër të zhvillimit të procedurës administrative, mjeteve juridike apo të ekzekutimit. 3. Forma e njoftimit përcaktohet duke pasur parasysh sigurimin e mbrojtjes ligjore të palës, transparencën dhe kosto-efektivitetin e saj. Si dhe nenit 109 po të këtij ligji me të cilin thuhet se: *Format e njoftimit* 1. Njoftimi, kur personi është i pranishëm, mund të bëhet gojarisht apo në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme të komunikimit. 2. Njoftimi i një dokumenti të shkruar (në vijim: shkresa), kryhet nëpërmjet dërgimit me postë, në mënyrë elektronike apo nëpërmjet njoftimit formal sipas këtij Ligji. 3. Përjashtimisht njoftimet e shkurtra dhe urgjente mund të kryhen edhe me telefon”, kështu që mbi këtë bazë rrjedhë së janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankuesit.

Nisur nga konstatimet si me lart, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.831/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.